



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06/IA017

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 17 dhjetor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e  
Kërkesës lidhur me Afatet**

---

**Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:**

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit:**

Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit:**

Ben Emerson

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit:**

Dejvid Jang

**Mbrojtësit të Viktimave:**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:**

Venkatesvari Alagenda

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 169 dhe 170(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton panelin e Gjykatës së Apelit për të marrë vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Apelit kundër Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit (“Kërkesa”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 dhjetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit (“Vendimi mbi Paraburgimin”),<sup>2</sup> ku urdhëroi, ndër të tjera, vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi.<sup>3</sup>

2. Më 16 dhjetor 2021, z. Thaçi dorëzoi Kërkesën.

## II. DISKUTIM

3. Rregulla 169 e Rregullores përcakton se “[n]ë bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit, Kryetari cakton një panel të Gjykatës së Apelit pas paraqitjes së kërkesës për apel të ndërmjetëm të dorëzuar në bazë të së drejtës së vetvetishme [...], ose sikurse mund ta lypë nevoja” (theksimi i shtuar).

---

<sup>1</sup> IA017/F00001, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Apelit kundër Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit, 16 dhjetor 2021.

<sup>2</sup> F00624, Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit, 14 dhjetor 2021 (konfidencial).

<sup>3</sup> Vendimi mbi Paraburgimin, para. 103.

4. Duke pasur parasysh rëndësinë e marrjes së vendimit mbi Kërkesën *sub judice* para përfundimit të afatit të parashikuar për apelin, i cili ende nuk është dorëzuar, Kryetarja e gjykon të nevojshme të caktojë një panel të Gjykatës së Apelit në përputhje me rregullën 169 të Rregullores.

### III. CAKTIMI

5. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

### **KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:**

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Emilio Gati**

**Gjykatësen Nina Jorgensen**

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi Kërkesën.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premte, 17 dhjetor 2021  
Në Hagë,  
Holandë